

MASTER PROFESIONAL NË ADMINISTRIM PUBLIK

Emertimi akademik i studimit	Diplomë Master Profesional në Administrim Publik
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	AKREDITUAR me VENDIM Nr.37, datë 28.02.2025
Cikli i studimit	Cikli i dytë
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti Ekonomik , Institucion Publik, Akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t’u rregjistruar në programin e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” në Administrim Publik individët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe kanë fituar një diplomë universitare “Bachelor” në fushën e ekonomisë ose fusha të tjera të përafërta. 2. Kriteret e pranimit për këtë program studimi janë <i>si më poshtë vijon:</i> a. Kriteri i meritës. Nota mesatare e ponderuar e studimeve të ciklit të parë bachelor. b. Kriteri i rëndësisë. Koeficienti i profilit të studimeve Bachelor sa i takon përputhshmërisë me fushën dhe programin e studimit të Njesisë Bazë të Administrimit Publik paraqitet si më poshtë: • Kandidatët e diplomuar në Administrim Publik në Universitetin e Gjirokastrës, në të njëjtin profil/program studimi që është bërë aplikimi, koeficienti 1.0 • Kandidatët e diplomuar në Administrim Publik jashtë Universitetit të Gjirokastrës, në të njëjtin profil/program studimi që është bërë aplikimi, koeficienti 0.9. • Kandidatët e diplomuar në ekonomi në

	Universitetin e Gjirokastrës, jashtë profileve të studimit që është bërë aplikimi, koeficienti 0.85. • Kandidatët e diplomuar në ekonomi jashtë Universitetit të Gjirokastrës, jashtë profileve të studimit që është bërë aplikimi, koeficienti 0.8. • Kandidatët e diplomuar jo në ekonomi, jashtë profileve të studimit që është bërë aplikimi, koeficienti 0.7. 3. Përzgjedhja e kandidatëve fitues në programin e studimit Master Profesional në “Administrim Publik” do të jetë rezultat i produktit: Notë mesatare e ponderuar në programin e studimit bachelor * koeficient (sipas profilit dhe programit të studimit që aplikohet); duke gjeneruar kështu një listë vlerësimi e cila shpall si fitues të renditurit sipas kësaj listë brenda kuotave të paracaktuara nga NJB për këtë program studimi. 4. Studentët që kanë përfunduar studimet dhe janë diplomuar jashtë vendit në të njëjtin program ose programe të përafërta studimi, në rast pranimi duhet të kryejnë njësimin e diplomës pranë QSHA. 5. Kandidati duhet të ketë të mbrojtur një prej 5 gjuhët e huaja në përputhje me nivelet e parashikuara në Udhëzimin Nr. 10, datë 16.06.2023 (për një ndryshim në Udhëzimin Nr.52, datë 3.12.2015) , për “Përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e Arsimit të lartë, të ndryshuar” . (Niveli B1).
--	---

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit *Master Profesional në Administrim Publik* është të aftësojë studentët me njohuri teorike të përgjithshme dhe specifike të fushës së administrimit publik në kuadër të zhvillimeve të vullshme të teknologjisë së informacionit. Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar:

1. Përgatitjen e specialistëve të arsimit të lartë me njohuritë e nevojshme rreth organizimit dhe funksionimit të sektorit publik
2. Aftësimin e studentëve për tregun e punës dhe t'i përgatisë ata për karrierat e mëtejshme respektive.
3. Përgatitjen e specialistëve të aftë për hartimin e politikave publike dhe për zbatimin korrekt të tyre.
4. Ofrimin e një mësimdhënie bashkëkohore duke integruar teorinë me praktikën dhe raste studimore moderne.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e specialistit në administrimin publik.

Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi analitike, menaxheriale dhe komunikimi që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojë një performancë sa më të lartë në mjedisin institucional, publik apo ndërsektorial në të cilin do të veprojë si i punësuar në të ardhmen.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të tilla si ato të politikave publike, administrimit fiskal, auditimit në sektorin publik, ekonomiksit publik e menaxherial, lidërshipt, menaxhimit të projekteve, menaxhimit financiar në sektorin publik, planifikimit strategjik në sektorin publik, drejtimin e shpërblimit, etj.

VEPRIMTARITË FORMUESE

1. **Lëndë të formimit të përgjithshëm** (*Drejtim i Shpërblimit, Ekonomiks Menaxherial*) **12 Kredite**
2. **Lëndë të formimit karakterizues** (*Kontabilitet Publik, Etika në Administratën Publike, Menaxhimi Financiar në Sektorin Publik, Auditimi në Sektorin Publik, Komunikimi dhe Marrëdhënia me Publikun, Ekonomiks Publik, Planifikim Strategjik në Sektorin Publik*) **Kredite 45**
3. **Lëndë integruese** (*Menaxhim Projektsh, Sistemet e Informacionit të menaxhimit, Lidërship, E Drejtë Pune dhe Njohuri mbi Shërbimin Civil, Administrim Fiskal*) **Kredite 30**
4. **Lëndë me zgjedhje** (*Vlerësimi i Politikave, MBNJ në Sektorin Publik, Administrim European*) **Kredite 6**
5. **Lëndë të formimit plotësues** (*Praktika Profesionale*) **Kredite 12**
6. **Përgatitje Punim Diplome/ Provim Formimi** **Kredite 15**

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	Deri në 44 pikë
5 (pesë)	45-54 pikë
6 (gjashtë)	55-64 pikë
7 (shtatë)	65-74 pikë
8 (tetë)	75 – 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma juaj e ciklit tëdytë “Master Profesional” në *Administrim Publik* është ura lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula jonë “Master Profesional” në Administrim Publik është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Prandaj detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë e një tregu pune dinamik, të globalizuar dhe gjithnjë në transformim, veçanërisht në sektorin e administrimit publik si dhe fushat ndërdisiplinore që lidhen me to.

Studenti i cili diplomohet në programin e studimit “*Master Profesional*” në *Administrim Publik* mundet të vazhdojë studimet në një program të ciklit tëdytë “*Master Shkencor*” bazuar në kriteret e vendosura nga Universitetet, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit.

Vetëm pas mbarimit të këtij cikli studimi, studentëve do t’u hapen mundësitë për punësim më të sigurtë dhe për studime të mëtejshme, duke avancuar dijet e tyre në aspekte teorike dhe ato praktike.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë në fushën e administrimit publik, të kualifikuar me njohuri të tilla si ato të politikave publike, administrimit fiskal, auditimit në sektorin publik, ekonomiksit publik e manaxherial, lidërshipt, menaxhimit të projekteve, menaxhimit financiar në sektorin publik, planifikimit strategjik në sektorin publik, drejtimin e shpërblimit, etj. Për këtë arsye synimi i programit të studimit “Master Profesional” në Administrim Publik është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen në :

1. Institucione të administratës publike qendrore dhe vendore
2. Agjenci rregullatore dhe ente publike
3. Organizata ndërkombëtare
4. Organizata jofitimprurëse
5. Sektorin akademik, kërkues ose konsulencën profesionale në administrim dhe politika publike.

Studentët të cilët përfundojnë programin e studimit “Master Profesional” në Administrim Publik fitojnë njohuri në fushat kyçe të funksionimit të administratës publike, përfshirë ato të politikave publike, administrimit fiskal, auditimit në sektorin publik, ekonomiksit publik e manaxherial, lidërshipt, menaxhimit të projekteve, menaxhimit financiar në sektorin publik, planifikimit strategjik në sektorin publik, drejtimin e shpërblimit dhe zhvillimin e aftësive ndërpersonale dhe analitike të nevojshme për të kontribuar në përmirësimin e institucioneve publike dhe ofrimin efektiv të shërbimeve për qytetarët.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (plani mësimor)

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i parë				
1.	Drejtim i Shpërblimit	6	60	I
2.	Ekonomiks Menaxherial	6	60	I
3.	Kontabilitet Publik	7	60	I
4.	Etika në Administratën Publike	6	60	I
5.	Menaxhim Projektesh	6	60	I
6.	Menaxhimi Financiar në Sektorin Publik	7	60	II
7.	Auditimi në Sektorin Publik	7	60	II
8.	Komunikimi dhe Marrëdhënia me Publikun	6	60	II
9.	Sistemet e Informacionit të menaxhimit	6	60	II
10.	Lidership	6	60	II
Gjithsej viti i parë		63 ECTS	600 orë	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Ekonomiks Publik	6	60	I
2.	E Drejtë Pune dhe Njohuri mbi Shërbimin Civil	6	60	I
3.	Planifikim Strategjik në Sektorin Publik	6	60	I
4.	Administrim Fiskal	6	60	I
5.	Lëndë me zgjedhje	6	60	I
	Vlerësimi i Politikave			
	MBNJ në Sektorin Publik			
	Administrim European			
6.	Praktika Profesionale	12	300	II
7.	Punim Diplome/ Provim Formimi	15	50	II
Gjithsej viti i dytë		57 ECTS	650 orë	